Të gjithë poligonet e ndërtesave si "Building - Ndërtesat", "BuildingPart – Pjesë ndërtese", "Agricultural Building – Ndërtesat bujqësore", "Production Building – Ndërtesat prodhuese", "AsigAreaBuilding", duhet të kenë një "Spot Elevation Pike me kuotë" brenda tyre.

Në projekt, pozicionimi vertikal i një ndërtese duhet të jetë "topOfConstruction – Pjesa e sipërme e konstruksionit".



<SpotElevation (Ground) – Pika me kuotë në terren >



2.1.1.9 Tipologji të tjera - Other features

<ASIG Area Transport Feature: Square - Tipologjitë sipërfaqe të transportit ASIG: Shesh >

Sheshe janë përcaktuar ndarësit apo ishujt në rrethrotullime të rrugëve.



<ASIG Area Transport Feature: Stairs - Tipologjitë sipërfaqe të transportit ASIG: Shkallë>

Shkallët janë përcaktuar si shkallët me shtrirje të gjerë si hyrje për objektet publike.



<ASIG Area Building Feature: Swimming pool - Tipologjitë sipërfaqe të transportit ASIG: Pishinë/Shatërvan>

Pishinat/Shatërvanet janë si të dhëna të "ASIG Building Feature-Tipologjitë ndërtesa ASIG" me vlerë atributi me kuotë 0..

2.1.2. Përpunimi në software

JPT rekomandon që APT do të përgatisë vetë "vidio tutoriale" për secilin përpunim të software-it anë të soft-eve falas (e.g. VLC Media Player) për trajnimet në të ardhmen.

2.1.2.1 Vendosija e parametrave për herë të parë



"Stereo Analyst" për ArcGIS është një soft që operon njëherësh si me "ArcGIS Edit Tool" po ashtu dhe me "Stereo view". "Stereo view" bazohet në përpunimin e skedarëve të bllok-imazheve fotogrametrike (Shiko manualin fotogrametria).

Për një projekt standard, të gjithë informacionet e kameras apo të sensorëve i përmban struktura e skedarit të bllokut dhe nuk kërkon ripërpunim


Hapat e mëposhtëm paraqesin përgatitjen e punës me *Analyst work (ArcGIS desktop)*

(1) Shtoni Stereo Analyst for ArcGIS

Hani një faqe të re "Blank Map" në ArcGIS Desktop dhe selektoni mbi "Extensions" në menunë "Customize"




(2) Aktivizoni "Stereo Analyst".




(3) Importoni skedarit që përmban projektin nga ERDAS Imagine


Përgatitsni një skedar fotografimetrik për bllok imazhet dhe pastaj hapeni në ArcGIS desktop duke selektuar "Import Project" nga menuja Stereo Analyst, kështu do ju aktivizohet një dritare që jep një informacion shpjegues.




Klikoni "Next" që të shfaqet faqja për të selektuar projektin fotografimetrik.




Klikoni mbi butonin me kuadratin e kuq për të selektuar projektin "Select Project File" dhe shkoni në direktorinë që përmban skedarin e projektit.




Klikoni skedarin që duam.



Nëse skedari e bllokut nuk ka "Online", klikoni qelizën e kuqe poshtë emërtimit "Online" dhe selektoni imazhin e kërkuar që të lidhet..



Një përmbledhje e detajeve të projektit paraqitet në dritaren "Project Summary"



Rrjeti kryesor i qelizave paraqet adresën e të dhënave për secilin imazh në projekt. Qelizat e mbetura tregojnë statusin e shtresave të piramidave dhe nëse janë gjetur orientimet për secilën imazh në projekt. Ato janë si më poshtë:

- ID – Paraqet një numër identifikues për secilin imazh në bllok. Mund të ndryshoni identifikuesin duke klikuar mbi qelizë.
- Active –Përcakton cilat imazhe do të përdoren. Të gjitha imazhet janë aktive si shabllon.
- Image Name – Liston adresën e direktorisë dhe emrin e skedarit për secilën imazh. Kur specifikohet adresa e plotë për figurën, kolona përkatëse në "online" bëhet e gjelbër.
- Online – Tregon nëse adresa për një imazh është e prishur. Nëse ndonjë prej qelizave në kolonën "online" është e kuqe, klikoni brenda një qelize dhe gjeni në vendndodhjen e imazhit. Nëse imazhet e tjera në projekt janë në të njëjtin direktori, programi rregullon automatikisht adresat e


tyre.

- Pyr – Tregon praninë e shtresave piramidale. Nëse ndonjë prej qelizave në kolonën Pyr (piramidat) është e kuqe, klikoni brenda saj për të hapur një dritare, e cila specifikon se programi llogarit shtresa piramidale për imazhet. Piramidat nuk llogariten deri në përfundimin e procesit të importit, të treguar duke klikuar butonin “Finish” në dritaren e fundit.
- Stats – Specifikon nëse llogaritja statistikave në dritaren e importimit është e vlefshme ose jo. Nëse ndonjë prej qelizave në kolonën Stats (statistikat) është e kuqe, klikoni brenda saj për të hapur një dritare që specifikon se programi llogarit statistikave për imazhet. Statistikat nuk llogariten deri në përfundimin e procesit të importimit duke klikuar mbi butonin Finish në dritaren e fundit.
- Int. – Specifikon nëse parametrat e orientimit të brendshëm janë të plotë ose jo.
- Ext. – Specifikon nëse parametrat e orientimit të jashtëm janë të plotë ose jo.


Klikoni Next që të shfaqni dritaren që lidh ose editon lartësinë mesatare të terrenit (mean Z) dhe variacionin, ose të specifikoni një skedar që përmban terrenin.

Vlerat e lartësisë mesare (*Mean Z*) dhe gjysma (*Half Z*), së bashku duhet të përfaqësojnë shkallën të shtrirjes vertikale të lartësive Z për imazhet e orientuara. Shtrirja e plotë fillon me vlerën ($Mean_Z - Half_Z$) dhe mbaron me vlerën ($Mean_Z + Half_Z$).

Këto vlera përdoren vetëm për të përmirësuar paraqitjen e imazheve të orientuara në dritaren “ArcMap document” duke optimizuar ri-projektimin e koordinatave të faqes së punës (map document) në koordinatat e imazhit të orientuar dhe për të siguruar një pikë më të mirë ngarkese për imazhet në dritaren e Stereo efektit. Me një pikë të përmirësuar ngarkese, na shfaqen më pak paralakse-X X-paralele për të pastruar në dritaren e Stereo efektit pas fillimit të punës me të dhënat. Editimi i këtyre fushave është opsionale dhe në asnjë mënyrë nuk ndikon në rezultatin origjinal të triangolacionit.




Klikoni Next që të shfaqni dritaren që paraqet sistemin koordinativ horizontal aktiv në projektin fotogrametrik




"Stereo Analyst" për ArcGIS ofron mbështetje të zgjeruar për sistemet koordinative dhe transformimet e tyre.


Klikoni butonin "Modify" për të përcaktuar sistemin koordinativ horizontal nëse nuk është i përcaktuar.




Klikoni Next që të shfaqni dritaren që paraqet sistemin koordinativ vertikal aktiv në imazhet e orientuara.



Klikoni butonin "Modify" për të përcaktuar sistemin koordinativ vertikal nëse nuk është i përcaktuar.



Klikoni "Next" që të shfaqni dritaren që përmban informacionin përmbledhës mbi proceset e realizuara dhe më pas klikoni "Finish"




Klikoni kutinë e aktivizimit të "Create *.blk" nëse doni të krijoni një skedar për një bllok me sensor të përzier dhe pastaj klikoni "Finish" që të importoni projektin.

2.1.2.2 ArcGIS (Fillimi i punës me Stereo Analyst)


(1) Shtimi i paneleve të kërkuara.

Klikoni menunë "Customize", e pozicionuar në panelin kryesor sipër, dhe më pas aktivizoni "Stereo Analyst" që ta shtoni atë në panelin e faqes kryesore të ArcMap.



(2) Paneli "Stereo Analyst "


Paneli "Stereo Analyst" përdoret për të aksesuar funksionet dhe veprimet që lidhen me "Stereo Analyst for ArcGIS"



[1]	Stereo Analyst	Ka akses të disa funksioneve dhe të ndihmës për "Stereo Analyst desktop"
[2]	Image Pairs	Selekton çiftet e imazheve që duhet të paraqiten në efektin Stereo.
[3]	Stereo Window	Shfaq dritaren e efektit Stereo. Mund të shfaqti vetem një Stereo në një kohë. Për më shumë info shikoni Adjust the Stereo Window"
[4]	Image Pair Selection Tool	Selekton çiftet e imazheve nga dritarja e ArcMap-it, në vend që të selektohen nga lista rendore. Gjithashtu përdoret ky funksion për të sinkronizuar pamjen Stereo me dritaren paraqitur në ArcMap
[5]	Auto load Image Pairs	Ndërron në mënyrë automatike pamjen e stereo çifteve në dritaren Stereo në momentin që kursori shkon në kufirin e një tjetër çifti imazhesh.

(3) Paneli "Stereo View"

Paneli "Stereo Analyst" përdoret për të aksesuar funksionet dhe veprimet lidhur me "Stereo Analyst for ArcGIS".





[1]	Auto Toggle 3D Floating Cursor – Mblidhni tipare pa lëvizje.
[2]	Manually Toggle 3D Floating Cursor –. Klikoni këtë buton që të përdorni tastin F3, për të ndezur ose fikur kursorin lundrues 3D në dritaren Stereo.
[3]	Zoom In and Out Tool – Zmadhoni dhe zvogëloni figurën e stereo çiftit
[4]	Roam Tool – Rregulloni pozicionin e çiftit të imazheve në dritaren Stereo. Klikimi i dyfishtë në dritaren Stereo kthen kursorin në një shigjetë për të lejuar lundrimin automatik që ndjek drejtimin e lëvizjes së mous-it.
[5]	Fixed Cursor Mode – Lejon kursorin të mbetet i palëvizshëm. Përdorni këtë komandë për të dixhitalizuar tiparet lineare, siç është një autostradë.
[6]	Terrain Following Mode – Vendos automatikisht kursorin lundrues 3D në sipërfaqen e tokës ose të një elementi që na intereson
[7]	Zoom in by 2 and Zoom Out by 2 – Zmadhon ose zvogëlon me një shkallë të dyfishtë.
[8]	Default Zoom – Kthen ekranin e stereo çiftit në një pamje të ekranit 1: 1, ku një pixel imazhi është i barabartë me një pixel në ekranin e kompjuterit.
[9]	Zoom to Data Extent – Paraqet në dritare pamjen e plotë të stereo çiftit.
[10]	Scale – Klikoni shigjetën për të zgjedhur një shkallë të paracaktuar ose shtypni një shkallë të përcaktuar nga përdoruesi në kuadrat.
[11]	Synchronize Geographic Displays – Modifikon ekranin në ArcMap në mënyrë që të përputhet me ekranin në dritaren Stereo.
[12]	3D Position Tool – Hap dritaren “3D Position Tool”, ku mund të futni koordinatat specifike X, Y dhe Z. Ekranin në dritaren Stereo ndryshon në mënyrë që koordinata e pikës së futur të jetë e përqendruar në dritaren Stereo.
[13]	Invert Stereo Model – Ndërron kanalet stereo të caktuara për secilën imazh në çiftin e imazheve. Kjo përmbys perceptimin e lartësisë, duke bërë që lartësitë të shfaqen në thellësi dhe kodrat duket se janë lugina.
[14]	Flip Window – Flips the stereo pair in the Stereo window 180 degrees. Rrokullis stereo çiftet në dritaren Stereo 180 gradë
[15]	Refresh Features Tool – Rifreskon tipologjitë në dritaren.
[16]	Automatic Grid – Mbledh pikat e tipologjie në një model të rregullt rrjeti. Mund të specifikojë



	hapësirën e rrjetit, shtrirjen dhe vendndodhjen e fillimit në panelin “Grid Drive Properties” të dritares “Stereo Analyst Options”
[17]	Height Difference – Mat lartësinë, pjerrësinë dhe gjatësinë e një objekti.
[18]	Display/Hide Features in Stereo Window – Aktivizon ose çaktivizon tipologjitë në dritaren Stereo.
[19]	Set Area of Interest –. Përcakton një zonë pune në të cilën tipologjitë ruhen.
[20]	Tabular 3D Snap – Shfaq një pamje tabelare të përmbajtjes “3D Snap Window”.

2.1.2.3 Karakteristikat e “Topo mouse”

Shkoni tek “Devices” dhe klikoni “Button mapping”.



Selektoni “Stereo Analyst” nga dritaria “Categories” dhe pastaj selektoni komandën që doni nga dritarja “Commands/Buttons”. Pastaj klikoni një një buton nga *Topo-mouse*-i ku doni të vendosni funksionin dhe klikoni “Assign”. Nëse parametet e ndryshuar kërkojnë të ruhen pas ndryshimit, klikoni “Save” gjithashtu ruani dhe skedarin “DXT”



2.2. Vlerësimi i cilësisë

2.2.1. Të përgjithshme

DPS2 dhe manuali "QE_Guideline.pdf" duhet ti referohen Vlerësimi të Cilësisë. Në "Vlerësimin e Cilësisë", realizohen "Kontrolle vizuale" dhe "Kontrolle logjike". Si rezultat i Vlerësimi të Cilësisë, produkti i "Mbledhjes së të dhënave (Plotimi Dixhital)", duhet ti nënshtrohet "Kontrollit vizual" dhe "Kontrollit logjik" (si "Kontrolli topologjik" ose "Kontrolli Automatik/Gjysëautomatik", po ashtu dhe për produktin e "Editimit dixhital").

2.2.2. Metoda e vlerësimi të cilësisë


2.2.2.1 Kontrolli tematik (Kontroll vizual në monitor)

Shfaqni të gjitha topologjitë në faqen e punës me ArcGIS, një e nga një, në rast se identifikoni ndonjë objekt të pa përshtatshëm (p.sh. Mbivendosjet e objekteve në tipologjinë e ndërtesave), spotojeni atë në një shtresë të përshtatshme.

(1) Spostimi i të dhënave në një shtresë tjetër.

Nëse një element i është krijuar në mënyrë të papërshtatshme, spostojeni atë tipologji nga një shtresë (p.sh. "Building-Ndërtesa") në një tjetër shtresë (p.sh. "BuildingPart-Pjesë ndërtese").

Selektoni objektit që do spostoni dhe shtypni me tastjerë "Ctrl X" dhe pastaj në dritaren ku jeni "Ctrl V"



2.2.2.2 Krahasimi me ortofoto (Kontrolli visual në monitor dhe në Hartë letër)

Shfaqni të mbivendosura të gjithë tipologjitë mbi Ortofoto. Kontrolloni të gjithë tipologjitë në monitor ose në hartë të printuar (shkalla 1/2000) dhe në rast të një gabimi apo ndonjë paqartësie mbajeni shënim duke krijuar një "shapefile" (pike vijë apo polygon) ose në letër me komente bazuar dhe me tabelen 1

² Data Product Specification – Specifikimet e të dhënave të produktit




Table1. Komentet e inspektimit

Komenti		E dhëna	Shembull i një komentimi				
			Madhësia e elementit	Shape	Atributi	Gjeometria	Tjera
SHT	Shto	Mungon elementi madhësia e të cilit përmbush tolerance dhe ekziston në ortofoto	Shto BU				Shto tekstin
FSH	Fshij	Objekt i pa dukshëm dhe i pa nevojshëm mbi ortofoto.	Fshij BUP				
ND	Ndrysho (Modifiko)	Mospërputhje ndërmjet elementit të vizatuar dhe ortofotos		ND Shp (Ndrysho shape-in) ND Zgjatjen e rrugës (Zgjat gjatësinë e rrugës) ND lidhjen (përputhja e lidhjes të jetë e përshtatshme) ND Prej (Shkëput) ND Lidh	ND Atrb (Ndrysho klasifikimin, atributin, emërtimin etj.)	ND poligon (Ndrysho poligonin)	ND Drejtimin (Ndrysho drejtimin)
SP	Sposto	Mospërputhje pozicionimi ndërmjet elementit dhe ortofotos					SP Pusetën SP Tekstin
VT	Kontrollo për verifikimin në terren	Tipologji e pa përditësuar nga verifikimi në terren përveç "pa përdorshme" dhe "rikontroll"	Vt (i pa përditësuar)	VT Shp (Mospërputhje ndërmjet elementit dhe faktit në terren realizuar nga verifikimi)	VF Atrb (Mospërputhje mes attributeve të elementit dhe faktit në terren nga verifikimi)		
KNT	Kontrollo përsëri	Tipologjia kërkon një "rikontroll" përveç atyre që janë të shënuara me "Shto" "Fshij", "ND" "VT",	Knt (Çfarë është?) Knt SideWalk/Trotuarin (kontrollo nëse ekziston trotuari) Knt Fence/Ndarjen (kontrollo nëse ndarja është me e madhe se 20 m)	Knt Shp (kontrollo shapefile-in)	Knt Atrb (kontrollo klasifikimin, atributin, emërtimin etj.)	Knt Gjeo (kontrollo gjeometrinë)	Knt Stereo (kontrollo në StereoModel) Knt Pozicionin (Kontrollo pozicionin)

2.2.3. Lloji i cilësisë

2.2.3.1 Plotësimi/Kompletimi

(1) Tepërt/Excess

Krijimi ose përfitimi i objekteve gjatë punës kur nuk ekziston asgjë, si pasojë e mbledhjes së të dhënave dhe klasifikimeve të gabuara.

(2) Mungon/Missing

Mungesa e objekteve gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave të kërkuara.



2.2.3.2 Përputhja logjike

(1) Përputhja konceptuale

Shkalla e përshtatshmërisë të të dhënave me Skemën e aplikimit e përcaktuar në DPS³.

(2) Përputhja me domeinin

Shkalla e përshtatshmërisë të attributeve të të dhënave me Skemën e aplikimit e përcaktuar në DPS.


(3) Përputhja me formatin

Shkalla e përshtatshmërisë me Strukturën e të dhënave e përcaktuar në DPS.

(4) Përputhja topologjike


Shkalla e përshtatshmërisë me topologjinë e të dhënave. (p.sh. objektet e përcaktuara si sipërfaqe janë saktësisht të mbyllura, objektet që janë të përcaktuara si linja janë të lidhura në mënyrë korrekte) Shikoni kapitullin 3.

³ Data Product Specification – Specifikimet e të dhënave të produktit



2.2.3.3 Saktësia pozicionale

Shikoni “DPS (Data Product Specification – Specifikimet e të dhënave të produktit)”.



2.2.3.4 Saktësia tematike

(1) Korrektësia e klasifikimit


Shkalla e përshtatshmërisë me klasifikimin e attributeve (p.sh. ndërtesat bujqësore nuk klasifikohen si park).

(2) Pa-korrektësia sasiore e attributeve

Shkalla e përshtatshmërisë të të dhënave të attributeve (jo sasiore) (psh. Emërtimi i ndërtesës është i njëjtë me rezultatin e Verifikimit në terren).

(3) Saktësia sasiore e atributiveve

Shkalla e përshtatshmërisë së të dhënave të atributiveve (sasiore) (p.sh. gjerësia e Rrjedhës ujore - Watercourse është e njëjtë me vlerën e të dhënave në atribut.).



2.3. Tabela e vlerësimit të cilësisë

Pas vlerësimit plotësoni tabelën "Topomap_QE_table.xls".

Shikoni "Manualin e kontrollit të saktësisë"⁴ që të kuptoni si të përmbushni tabelën.

2.4. Punimet për editimin e të dhënave

2.4.1. Të përgjithshme

Në "Editimin e të dhënave", gabimet logjike do të identifikohen dhe do të modifikohen pastaj tipologjitë e diskutueshme si poligonet, vijat, apo pikat do të krijohen në këtë proces.


2.4.2. Kontrolli i gabimeve logjike

2.4.2.1 Kontrolli topologjik


(1) Krijoni një "File geodatabase" të re si dhe "Feature dataset" të ri

Ekstraktoni dhe ruani skedarin SDE nga server në direktorinë lokale "Local Drive"


Përndryshe krijoni një *GDB(Filegeodatabase)* dhe *FeatureDataSet* bosh pastaj eksportoni *FeatureClass*-et që ju interesojnë në *Geodatabase*.




⁴ Accuracy Control manual




(2) Përgatitni Feature Class-et




(3) Krijoni një "Topology" të re




Krijoni një topologji të re dhe vendosni emërtimin.


















Selektoni "Feature class-et" (1 ose më shumë) nga "Feature dataset-i" objektiv.



Vendosni rregullat topologjike me "Add Topology Rule" dhe zgjidhni rregullat e kërkuara "Rule" nga kutia rrëshqitëse.




	Regullat për linjat	Gabimi i shfaqur	Gabimi objektiv		Regullat për linjat	Gabimi i shfaqur	Gabimi objektiv
1	<i>Must not Overlap – Nuk duhet të mbivendosen</i>	Linjë  Line errors are created where lines overlap.	Mbivendosje (dublikime)	9	<i>Must Not Overlap With – Nuk duhet të mbivendosen me: (një Feature Class tjetër)</i>	Linjë  Line errors are created where lines from two feature classes or subtypes overlap.	Mbivendosje (dublikime)
2	<i>Must not Intersect – Nuk duhet ndërpritet (brenda një Feature Class-i)</i>	Linjë Pikë  Line errors are created where lines overlap, and point errors are created where lines cross.	Mbivendosje (dublikime) Ndërprerje (tejkalim)	10	<i>Must Not Intersect With – – Nuk duhet ndërpritet me: (një Feature Class tjetër)</i>	Linjë Pikë  Line errors are created where lines overlap, and point errors are created where lines cross.	Mbivendosje (dublikime) Ndërprerje (tejkalim)
3	<i>Must Not Intersect Or Touch Interior – Nuk duhet ndërpritet ose të ketë prekje përbrenda (brenda një Feature Class-i)</i>	Linjë Pikë  Line errors are created where lines overlap, and point errors are created where lines cross or touch.	Mbivendosje (dublikime) Ndërprerje (Mbikalime) Prekje	11	<i>Must Not Intersect Or Touch Interior With – Nuk duhet ndërpritet ose të ketë prekje me: (një Feature Class tjetër)</i>	Linjë Pikë  Line errors are created where lines overlap, and point errors are created where lines cross or touch.	Mbivendosje (dublikime) Ndërprerje (tejkalim) Prekje
4	<i>Must Not Self – Intersect – Nuk duhet të ketë vetë-ndërprerje</i>	Pikë  Line errors are created where lines overlap themselves, and point errors are created where lines cross themselves.	Vetë-ndërprerje	12	<i>Must Be Single Part – Duhet të jetë një element i vetëm</i>	Linjë  Multipart line errors are created where lines have more than one part.	E përbërë nga shumë pjesë
5	<i>Must Be Covered By Boundary Of – Nuk duhet të mbulohet nga kufiri i : (Poligoni i një Feature Class-i tjetër)</i>	Linjë  Line errors are created on lines that are not covered by the boundaries of polygons.	Linjë që nuk i korrespondon një poligoni	13	<i>Endpoint Must Be Covered By – Pika fundore duhet të mbulohet nga: (Node - Pikë)</i>	Point  Point errors are created at the ends of lines that are not covered by a point.	Pikës fundore nuk i korrespondon një pikë (pikë)
6	<i>Must Not Have dangles – Nuk duhet të ketë pike shkëputëse</i>	Pikë  Point errors are created at the end of a line that does not touch at least one other line or itself.	Shkëputje	14	<i>Must Be Covered By Feature Class Of – Duhet të mbulohet nga Feature class-i i: (një Feature Class tjetër)</i>	Linjë  Line errors are created on the lines in the first feature class that are not covered by lines in the second feature class.	Line without corresponding Line – Linjës nuk u korrespondon një linjë (një Feature Class tjetër)
7	<i>Must Not Have Pseudo Nodes – Nuk duhet të ketë pike këputje të panevojshme</i>	Pikë  Point errors are created where the end of a line touches the end of only one other line.	Një segmentim i panevojshëm	15	<i>Must Be Inside – Duhet të bjeri brenda</i>	Linjë  Line errors are created where lines are not within polygons.	Line not covered by corresponding polygon – Linja nuk mbulohet tërësisht

8	<i>Must Not Self – Overlap – Nuk duhet të ketë Vetë-mbivendosje</i>	Linjë	 <p data-bbox="750 193 846 258">Line errors are created where lines overlap themselves.</p>	Vetë mbivendosje (Dublikime)					nga poligoni
---	---	-------	--	------------------------------	--	--	--	--	--------------


2.4.2.2 Shembull i kontrollit të mospërputhjes

(1) Krijoni një "File geodatabase" dhe "Feature dataset" të ri

Pasi të krijoni një "topology", selektoni rregullin "Must Not Have Dangles".




Kapni dhe zvarritni tipologjinë e krijuar dhe hidhne në dritaren kryesore. Gabimet e pikave duhet të shfaqen.



(2) Eksportoni gabimin topologjik në një "shape file"

Selektoni "Export Topology Errors" nga direktoria ArcToolbox, menuja "Data Management Tool" dhe eksportoni skedarin e topologjisë në format "shape file".



2.4.2.3 Përputhja e kulmeve

Kontrollo dhe modifiko përputhjen e kulmeve duke shfrytëzuar rregullin topologjik “Must Not Have Dangles”


2.4.2.4 Kontrolli automatik i Modelin dixhital të terrenin (Izoipset, pikat me kuotë) - EL (Contour line, Spot Elevation.)

(1) Kontrolli i vlerës së Izoipseve - Contour Lines


Kontrolloni vlerat: 0 m, jo konstante, gabimet e mëdha në kuota nga tabela e attributeve


(2) Krijoni një “raster GRID” nga Izoipset - Contour line (duke shfrytëzuar TIN)

Një kontroll logjik ndërmjet *Izoipseve – Contour line* dhe *Pikave me kuotë – Spot elevation*, mund të bëhet me komandat e ArcGIS-it.



Krijoni një "GRID RASTER" nga TIN.





Përfundimisht, llogaritni tabelen e vlerësimit të rezultateve të GCP. Nëse dalloni ndonjë gabim, kontrolloni arsyen pse ka ndodhur dhe modifikoni gabimin.

FID	Shape	Field1	Field2	Field3	Field4	createTin6
0	Point ZM	10220	486788.536	4572753.173	178.023	177.559
1	Point ZM	10250	489440.981	4570117.028	159.997	159.991
2	Point ZM	30100	459894.22	4567889.072	1.023	-9999
3	Point ZM	30120	460823.139	4567950.092	14.556	-9999
4	Point ZM	30090	459302.782	4572097.296	3.029	-9999
5	Point ZM	10190	484027.784	4574109.52	193.893	-9999
6	Point ZM	10260	489469.696	4574748.494	240.829	-9999
7	Point ZM	30070	457318.072	4574825.479	1.843	-9999
8	Point ZM	30040	453819.622	4575141.666	1.676	-9999
9	Point ZM	30110	460681.749	4575871.41	20.282	-9999
10	Point ZM	10160	479827.676	4576522.627	97.911	-9999

2.4.2.5 Kontrolli automatik për ndërtesat (BU, PF, AF, AS)


(1) Pikat me kuotë (Në ndërtesa) - Spot Elevation (Building) dhe Ndërtesat - Building

Një pike me kuotë duhet të pozicionohet brenda një poligoni ndërtese ose pjesë ndërtese

Përdorni rregullin topologjik "Contains One Point" për të kontrolluar gabimet e mundshme.

(2) Përmban një pikë brenda - Contains one point

Shembull: Të gjitha Ndërtesat – Building ose Pjesë ndërtese – Building part duhet të kenë një Pikë me kuotë – Spot elevation brenda poligonit.




(3) Vlera e lartësisë së Pikës me kuotë - Spot Elevation (Building)

Vlera e lartësisë (nga toka) e *Pikës me kuotë - Spot Elevation (Building)* duhet të jetë 0m ose më e madhe.

Llogaritni vlerën e lartësisë së *Pikës me kuotë - Spot Elevation* duke përdorur DTM për të kontrolluar këtë gabim.


2.4.2.6 Kontrolli automatik për ndërtesat (e.g.LC)

Shembull: të gjithë poligonet e LC (*Land Cover - Mbulesës së tokës*) nuk duhet të mbivendosen me njëri-tjetrin



(1) Nuk duhet të ketë hapësira - Must not have gaps


Shembull: Të gjithë poligonet e LC (*Land Cover - Mbulesa e tokës*) nuk duhet të kenë hapësira ndërmjet tyre.



(2) Duhet të mbulohet nga "feature class-i" i - Must be covered by feature class of


Shembull: Të gjithë poligonet e "WaterCourse – Rrjedhës ujrore" duhet të mbulohen nga poligonet e "LC – Mbulesës së tokës" (511WaterCourses).

Shembull: Të gjithë poligonet e "StandingWater – Pellgjeve" duhet të mbulohen nga poligonet "LC – Mbulesës së tokës" (512WaterBodies).



(3) Nuk duhet të mbivendosen me - Must not overlap with

Shembull: të gjithë poligonet e "WaterCourse – Rrjedhës ujore" duhet të mbulohen nga "LC – Mbulesës së tokës" (511WaterCourses).



2.4.3. Tipologjitë që krijohen me post-procesim

2.4.3.1 Rrjeti i transportit (Transport Network - TN)

(1) Zonat rrugore (Road Area) and Karregjata (VehicleTrafficArea)

<Zonat rrugore - Road Area>

Pas kontrollit automatik (p.sh kontrolli topologjik) të linjave rrugore, duhet të krijoni poligonet nga vijat (përdorni ArcGIS "Feature To Polygon" në menunë "Data Management Tool").


<Zona e trafikut të automjeteve - Vehicle Traffic Area>

Fshini "Sidewalk - Trotuaret", "Shoulder - Tankinat" dhe "Square - Sheshet" nga poligoni i "Road Area

– Zonat rrugore”, pastaj klasifikoni të gjithë poligonet sipas klasave të rrugëve (Highway-Autostradë, InterUrbanRoad-Rrugë interurbane, UrbanRoad - Rrugë urbane, VillageLocalRoad – Rrugë fshati lokale, Path - Shteg, Underconstruction – Rrugë në konstruksion, GardenRoad - Kalim, BicycleLane – Korsi bicikletash).

(2) Lidhjet rrugore - RoadLink


Pas përfundimit të TN (Rrjetit të transportit), Krijoni akset (center line) e rrugëve si Road Link - Lidhje rrugore. Rekomandohet nje komandë nga ArcGIS-i. (por duhet të realizohen disa përpunime në të dhënat paraprakisht).



(3) Nyje rrugore - RoadNode

Krijoni nyjet nga *Road Link – Lidhjet rrugore*. Rekomandohet nje komandë nga ArcGIS-i.

Pas gjenerimit klikoni komandën “Dissolve” që të fshini pikat e dublikuara.



2.4.3.2 Hidrografia (Hydrography - HY)

(1) “Rrjeti i rrjedhës ujore - WatercourseLink” and “Nyjet hidrike – HydroNode”

Krijoni një “*WatercourseLink - Rrjet të rrjedhës ujore*” nga poligonet e “*WatercourseA – Rrjedhjes ujore*” dhe pastaj krijoni “*HydroNode – Nyje Hidrike*” nga “*WatercourseLink - Rrjeti i rrjedhës ujore*” duke përdorur të njëjtat komanda si mësipër (Shikoni 2.4.2.1).

(2) Kufiri tokë ujë - LandWaterBoundary


Krijoni borderin nga poligonet e "WatercourseA- Rrjedhës ujore" dhe poligoneve të "StandingWater – Pellgjeve" me komandën "Feature To Line" në menunë "Data Management Tool".

Fshini linjat e panevojshme dhe klasifikoni ato me interpretim sipas klasave "Natural – Natyrale" ose "Manmade – Artificiale".


(3) Basenet - Basin

<Komanda "Basin" me ArcGIS>


Fillimisht krijoni "Flow Direction – Drejtimin e rrjedhës" me anë të komandave të ArcGIS nga skedari "GRID RASTER (madhësia e gridit e rekomanduar është 20m), i cili përftohet nga izoipset.




Më pas krijoni basenin "Basin".



Konvertoni rasterin e krijuar në poligon.




Shpërbëni poligonet e krijuara referuar lumit dhe GRID RASTER, po ashtu edhe sipas ortofotos.




<komanda "Basin" në QGIS>


Përgatitni DEM që nuk ka të dhëna si fillim. Pastaj hapni QGIS me GRASS7.





Hapni "Plugins" dhe kontrolloni "GRASS7"



Hapni një faqe të re "Mapset" nga "Plugins".





2.4.3.3 Modeli Dixhital i Terrenit (Elevation - EL)

(1) Rrjeti i mbulimit të lartësive - ElevationGridCoverage

Krijoni pika "multipoint" përgjatë elementëve sipas hapave të mëposhtëm:

Vendosni: *Contourline - Izoipset, SpotElevation* – Pika me kuotë (toka), KRGJSH.

Output: "10 grid multipoint"

Hapi 1: Krijoni TIN me ArcGIS sipas komandës "Create TIN" në "3D Analyst Tools" pastaj krijoni pikat "multipoint" nëpërmjet "Raster to Multipoint in 3D Analyst".

(2) **Vija thyerje - Breakline**

Në rastin e krijimit të DEM pa izoipse, është e nevojshme të krijohen "Breakline- Vijat e thyerjes". Vijat kufizuese të "StandingWater – Pellgjeve" duhet të përdoren si skarpatë.

(3) **"Zonat pa info – VoidArea" dhe "Zonat e izoluar – IsolatedArea"**




Në rastin e përdorimi të DEM-it ekzistues që ka *Zonat pa info – VoidArea* dhe *"Zonat e izoluar – IsolatedArea"*, rekomandohet të përgatiten edhe poligonet e këtyre zonave


2.4.3.4 **Mbulesa e tokës (Land Cover Unit - LC)**

Referohuni klasave të "Corine Land Cover"

Madhësia minimale e një poligoni individual duhet të jetë 100,000m² (100m x 100m).

Importoni "g100_clc12_V18_5.tif" dhe plotoni kufirin e secilit polygon të "Land use – Përdorimit të tokës" referuar imazheve

		
<p>Orthophoto</p>	<p>g100_clc12_V18_5.tif</p>	<p>Shembull i mbledhje së të dhënave (100m×100m)</p>



2.4.3.5 Ndërtesat (Building - BU)

(1) Konvertimi 3D sipas "Pikave me kuotë – SpotElevation"

Kulmet e *Building* - *Ndërtesave* apo *BuildingPart* – *Pjesë ndërtese* të kapura nga stereo modelet ka vlerë kuotë të ndryshme, gjithsesi ato nuk janë LoD1. Për këtë arsye, kërkohet të konvertohen tipologjitë e ndërtesave në 3D me një vlerë kuote (lartësia) me anë të *SpotElevation* - *Pikave me kuotë* (tokë).

Përdorni "Join Data (from another layer based on spatial location)" ndërmjet tipologjisë së ndërtesave dhe *SpotElevation* – *Pikave me kuota*, pastaj përdorni komandën "Feature To 3D By Attribute" në "3D Analyst Tools" që të krijohet ndërtesa të sheshta (DoL1).

